



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health**  
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 27.11.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.11.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik LAN GROUP SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e DDD në hapsirat e burgjeve për DSHB” me nr. të Prok: 206-23-11154-2-1-1, nxjerr:

**V E N D I M**

1. **Pranohet**, si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e operatori ekonomik LAN GROUP SH.P.K e dt. 19.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet e DDD në hapsirat e burgjeve për DSHB” me nr. të Prok: 206-23-11154-2-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të datës 13.10.2023;
2. Korrigohet, Njoftimi për Kontrate i datës 13.10.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, do ta publikoj Formularin standard për korrigjim te gabimeve;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik LAN GROUP SH.P.K., me date 19.11.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbimet e DDD në hapsirat e burgjeve për DSHB” me nr. të Prok: 206-23-11154-2-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 27.11.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga AK sipas OE ankues:

**Nenet: 1, 6, 7, 69, 70, te LPP-së**

**Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

## Përgjigjia e AK ne lidhje me pretendimet Ankimore te OE LAN GROUP SHPK

**Pretendimi Ankimor nr. 1** - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe /ose 9.1 & 9.2 -Kapaciteti teknik dhe profesional :

*Përgjigja : Shuma është më pak se 1.5 herë e shumës së paraparë të shërbimit, bazuar në çmimin e kontratës paraprake. Kjo është e rregulluar me nenin 68, paragrafi 1 te LPP Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës.*

*Në funksion të mundësitimit të pjesëmarrjes së sa më shumë ofertuesve, pretendimi ankimor merret si i bazuar dhe kërkesa do te përmirësohet përmes Formularit standard për korrigjim te gabimeve.*

*- AK do ta zvogëloj vlerën e referencave nga 600,000.00 ne 400,000.00 euro.*

Gjithashtu te kjo pike keni kërkuar qe OE te ofroj a.Së paku një kontratë për hapësira të Brendshme ku DDD është kryer pa lëvizjen e banuesve, pa zbrazjen e hapësirave gjatë procesit. b.Së paku një kontratë për largimin e zvarranikëve. Gabimi tjetër pardoksal aspak profesional ,si eshte a mundur qe te kerkohen nje kontrate për hapësira të Brendshme ku DDD është kryer pa lëvizjen e banuesve , ndersa te Specifikimet teknike keni kerkuar qe OE te ofroj MSDS e prapareteve per Dezinsektim ,Dezinfektimi dhe deratizimi .Nese shiqoni ne internet tdhe lexoni MSDS e produkteve te kerkuara do te informoheni shum lehte se a mund te perdoren ne prezencen e njerzve apo pa zbrazjen e hapsirave gjate procesit dhe cilat jan pasojet e tyre gjat aplikimit .

Po ashtu ne piken b. Së paku një kontratë për largimin e zvarranikëve, edhe ketu ne radhe te pare keni rene ne kundershtim me kerkesen e juaj ne piken 5,6 dhe 7 te Kerkasat e pershtatshmerise profesionale 7.1&7.2 ku keni kerkuar qe OE te jete I Certifikuar me ISO 9001:2015;14001;2015 dhe 4500;2018 te audituara per SHERBIME CILESORE TE DDD DHE LARGIMIN E GJARPERINJEVE. Si eshte e mundur te kerkohet nje kontarte te veqante per për largimin e zvarranikëve ku ne sherbimet e tilla hyn edhe largimi i zvarranikeve.

*Përgjigja: Ju lutem shikoni Formularin standard për korrigjimin e gabimit publikuar me date 25.10.2023. sepse kërkesa është ndryshuar.*

**Pretendimi Ankimor nr. 2** - Operatori Ekonomik duhet e dorëzoj një përshkrim te mënyrës së kryerjes së shërbimeve me detale për implementimin sipas fazave, i cili përshkrim duhet te paraqes metodat për mënyrën e zbatimit të punëve pa ndryshuar rutinat e burgut përfshirë edhe planin dinamik. Dëshmia e kërkuar dokumentare Evidenca 2 Përshkrimi i mënyrës se kryerjes se shërbimeve duke përfshirë planin dinamik

AK me rastin e parashtrimit te këtij kriteri po ashtu ka bërë diskriminim sepse OE qe deshiron te aplikoj ne kete procedure dhe me rastin e pergatitjes se Metodologjise se kryerjes se shërbimit dhe Metododat dhe menyren e zbatimit pa ndryshuar Rutinin e burgut te perfshihen ne planin dinamik. HABIJA JONË ËSHTË: Si mundet nje OE te dije rutinen e burgut dhe si mundet te behet nje plan i tille e kur kjo dihet qartë qe Plani Dinamik kryhet pas nenshkrimit te Kontrates dhe behet ne kordinim me Menaxherin e Kontrates si dhe me OE fitues dhe me ekte rast ngarkohet ne systemin eprokurimi.

Andaj kerkojmë qe kriteri i tille te eliminohet ne teresi sepse paraqet Diskrimin te hapur dhe eshte ne kundershtim me ligjin .Poashtu paraqet paqartesi ndaj OE qe deshirojne te aplikojne. (apo ka operatore ekonomik qe e din planin ?)



*Përgjigja: Sa i takon projektit paraprak për punën që duhet bërë në institucione, është çështja më bazike që duhet bërë para se të aplikohet, të dihet hapësira e brendshme dhe e jashtëm (e precizuar në çmimore), vendndodhja e tyre, koha kur mund të bëhet, rutinat, ndjeshmëria, mundësia e futjes vetëm të punëtorëve të cilët kanë të kaluar të pastër kriminale dhe mundësia e kryerjes konformë Rendit Shtëpiak në Institucionet Korrektuese <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=81434> i cili është publik dhe në gazetën zyrtare, të cilin është dashtë ta dini por po ua bashkëlidhim që ta keni më lehtë të hartoni projektin. Bazuar në këto dy të dhëna, natyrisht që është favorizuar institucioni dhe cilësia e shërbimit që kërkohet. DDD duhet të bëhet pa lëvizjen e banuesve. Shëtitja jashtë bëhet për qëllime të tjera dhe jo të gjithë të burgosurit mund të dalin në të njëjtën kohë, ndërsa në qendra të paraburgimit, që janë gjashtë sosh, as që lejohet të dalin dhe të takohen në mes vete. Sa i takon të punësuarve dhe e kaluara e tyre është kërkesë dhe rregulle ShKK që të verifikohet paraprakisht se kush mund të hyje e kush jo, janë rregulla që nuk mund të ndryshohen.*

*Kjo çështje nuk mund të ndryshohet, është çështje e sigurisë dhe ka funksionuar kështu që nga vitit 2010 pa vështirësi nga OE paraprak.*

**Pretendimi Ankimor nr. 3 - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe /ose 9.1 & 9.2 Kapaciteti teknik dhe profesional te Kërkesa 3**

**Kërkesa 3 Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit**

- a. Minimum tre (3) Gjenerator motorik Ultra Low Volume (ULV) me kapacitet së paku 100 litra.**
- b. Minimum dy (2) makinë Power Sprayer me kapacitet 500 litra**
- c. Minimum dhjetë (10) pompa Low Volume (LV).**
- d. Minimum (3) vetura për vendosjen e gjeneratorëve (Pick UP)**

**Evidenca 3 Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet te dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim**

Te gjitha këto pajisje vetëm për realizimin e këtij tenderi, i cili bazuar në Specifikimet e paramasave është i sterngarkuar me kerkesen e ketyre pajisjeve. Nëse krahasohet tenderet e njejte në shume institucione për sherbime te DDDse e që ka mbi 10 herë më shumë m2 dhe Hektar nuk janë kërkuar kaq shume paisje Kjo nuk eshte asgje tjetër perveq Favorzim ndaj nje apo dy OE të caktuar. Psh. kur jane kërkuar Minimum (2) makine Power Sprayer me kaptitet 500 Litra .Përveq që është kriter jo ligjor dhe jo profesional atëherë këtu kemi krykeput të bëjme me Favorzim për X kompanin e caktuar sepse qe nga tani ju tregoj se cila kompani i ka këto dy paisje me këtë kapacitet të kërkuar dhe po ashtu është qesharake të caktoni kapacitetin e Rezervuarit pasi që ky kriter është Diskriminues e Favorizues. Andaj ju si AK mund te kerkoni Automizer për Dezinsektim hapsinor pa caktuar kapacitetin e Rezervuarit pasi qe pasije te tilla kane shume OE prej 100 litrave e me shume ndersa per Pasije 500 litra e ka vetëm nje OE i caktuar. Po ashtu për pretendime të tilla kemi edhe shume vendime te OSHPse për hudhje të kriterëve të ngjajshme si Vendimet me numer: 2023/0264, 677/22

***Përgjigja për Pajisjet Teknike: në funksion të mundësimi të pjesëmarrjes së sa më shumë ofertuesve, është mundësuar që pajisjet të posedohen ose të merren me qira për dobi të projektit, e dëshmuar në dosje të tenderit. Pas marrjes së këtyre ankesave, është rishikuar kerkesa dhe do te korrigjohet permes formularit standard për korrigjim si më poshtë:***

***Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjete, stabilimetet dhe pajisjet teknike qe janë te domosdoshme për realizimin e projektit:***

- a. Minimum dy (2) Gjenerator motorik Ultra Low Volume (ULV) me kapacitet së paku 100 litra.**



- b. Minimum dy (2) makinë Power Sprayer me kapacitet 300 litra
- c. Minimum tetë (8) pompa Low Volume (LV).
- d. Minimum dy (2) vetura për vendosjen e gjeneratorëve (Pick UP)

*Deklaratat unike doganore ose kontrata/fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Ne rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzimin, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim.*

**Pretendimi Ankimor nr. 4 - Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale 7.1 & 7.2**

**Përshtatshmëria profesionale Kërkesa 4 OE-ik duhet të ofroj dëshmi për stafin profesional dhe atë si vijon a. Një (1) epidemiolog me licencë valide b. Një (1) agronom c. Dy (2) teknik sanitarë, me licencë valide d. Së paku 30 punëtor (korigjuar 10 punëtor) të punësuar gjatë tri vitet e fundit Dëshmia e kërkuar dokumentare**

E njoftojë AK se në bazë të Licencës së lëshuar nga Ministrija e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që i licencën kompanit për shërbime të DDDse kërkohet që kompania të posedojë njërin nga stafi si: Bujqësisë, Agronomisë, Epidemiolog, Ekolog, Veterinar, andaj pse AK në FTD ka kërkuar që kompania të jetë e licencuar për shërbime të DDDse nga institucioni përkatës ndërsa këndej ka kërkuar staf shtesë të licencuar që bie ndesh me perkatesin minimale për staf minimal për licencim si dhe bie ndesh edhe me Nenin 51 paragrafi 3 nenparagrafi 3.6 të Ligjit Nr. 04/L120 për Mbrojtjen e Bimeve të dates 17.01.2013 si dhe është në kundërshtim me shumë Vendime të OSHPse përkitazi me këtë qështje si Vendimi me numer 28322 (Referoju pretendimi numer 1 dhe Vendimit të OSHPse për këtë qështje), poashtu edhe vendimet tjera si 492/22. Poashtu edhe vendimi tjetër me numer 492/15 të dates 10.12.2015 andaj ka fakte dhe argumente të bollshme që AK ka vepruar me shumë praktika të deritanishme dhe duke shkelur shumë rënde shumë dispozita të LPPse.

*Përgjigja: është rishikuar kërkesa dhe do të korigjohet përmes formularit standard për korigjim si më poshtë:*

- a. Një (1) epidemiolog me licencë valide
- b. Një (1) agronom
- c. Dy (2) teknik sanitarë, me licencë valide
- d. Së paku 10 punëtor të punësuar përgjatë vitit, në tri vitet e fundit.

**Dëshmitë për stafin janë CV-a, Kopja e Diplomës, Kopja e licencës, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt.**  
 Lidhur me stafin, është bërë kërkesa për staf të përshtatshëm për natyrën e punës që pritet të bëhet në këtë institucion ku ka edhe banim, edhe vend punim, edhe pjesë bujqësore, serra, puse të ujit, ferma etj që përfshihet një ekosistem i tërë që nevojiten: agronomi përgjegjës për pjesën bujqësore dhe kujdesin për mjedisin, bimët, shtazët dhe njerëzit, epidemiologu për punët e tjera profesionale lidhur shërbimet parandaluese, planifikuese me DDD, ndërsa teknikët sanitar janë profesionistët e vetëm adekuat për këtë veprimtari, ku ka licencë nga Institucionet e Arsimit të Lartë të akredituar në Kosovë si teknik sanitar si dhe licencë punë nga MSh nga profesionet e rregulluara për këtë shërbim të cilët fillimisht licencohen nga MSh dhe pastaj ri licencohen nga OIK. Ne nuk kemi njohuri që ka shkollim adekuat dhe licencë punë për profesion të DDD-së në vend. Në rast se ka profesionist të DDD-së të shkolluar jashtë vendit dhe at kanë bërë nostrifikimin e diplomës e cila është ekuivalente me kompetencat për DDD të teknikëve sanitar nuk ka asnjë pengesë dhe nuk është çështje. Secila diplome e notifikuar ose barasvlerësuar me atë të teknikut sanitar nga NARIC është e vlefshme.



**Pretendimi Ankimor nr. 5 - Specifikimi teknik, Aneksi 1; Preparatet qe duhet te perdoren për DDD; Na sqaroni se pse te dezinfektuesit këna kërkuar preparate te ngjashme , ndërsa për deratizim, dezinfektim dhe replim te zvarranikeve nuk keni kërkuar preparate te ngjashme po vetëm preparate e prezantuara ( e qe i posedon X kopmanija e caktuar) .Pra edhe ne pergjigjen per Sqarime nga OE ju keni mbetur ne qendrimin e njeje pra kete e keni bere ne kundershtim me Ligjin pa perdorur fjalën Ekuivalente. Po ja perkujtoj AK se Ministrija e Ambinetit dhe Planifikimit Hapesinor leshon Vendim per perdorim te preparateve te DDD-se andaj AK po bie ne kundershtim qe nese nje preparat eshte i lejuar me vendim te MMPH-se te mos kete te drejte te prezentohet ne kete procedure.Kerkesa e jona eshte qe te lejohet fjala EKIVALENTE dhe poashtu te perdoret qe PREPARATET E PREZENTUARA TE KENI LEJEN PERKATESE PER PERDORIM NGA MMPH-JA e jo te perdore specifika per nje produkt te caktuar dhe favorozim per nje Mark tregtare pasi qe eshte ne kundershtim me ligjin e LPP-se nje praktike e tille .Per kete edhe kemi disa vendime te OSHP-se ne lidhje me kete pretendimin tonin. Dhe po ashtu një baze e mire per trajtim ne te ardhmen nga institucionet pergjegjese**

*Përgjigja: Preparatet janë ekologjike dhe të njëjtat që kanë qenë në kontratën paraprake, pa ndryshime dhe përpos preparatit për zvarranik të gjithë të tjerët kanë qenë dy e më shumë produkte. është rishikuar kërkesa dhe do të korrigjohet përmes formularit standard për korrigjim si më poshtë:*

1. *Dezinfektues: didecyldimethylammonium chloride 3.4gr, ose të ngjashme);*
2. *Deratizues: (brodifacoum 0.005% ose bromodialon 0.005%); ose të ngjashme nga prodhues të ndryshëm por këto dy substanca*
3. *Dezinsektues: (Bifenthrin 9,7 ose Fipronil 0.01 Yo ose Imidacloprid 10%; ose permethrine 30%, pyperonil butoxide 30%, ose të ngjashme nga prodhues të ndryshëm por këto tri substanca*
4. *Largimi i zvarranikëve: Cinnamon oil ose vajra të ngjashme për këtë qëllim;*

#### **Pretendimi Ankimor nr. 6 - Specifikimi teknik, Aneksi 1**

Po ashtu nje favorizim jo profesional trashanik i radhes edhe ne kete kriter AK për kete pike ku ka kerkuar gjenetaror ULV madhesi jo me shum se 20 mikrona dhe lartesi jo me pak se 15 metra po ashtu edhe gypa te gjate deri 100 metra dhe nje paradoksaltjeter ku kan cekur per dezinfektim(dezinfektimi eshte eliminimi I mikroorganizmave patogjen ) qe ska te bej fare me dezinfektim dhe tjetri gabim jo profesional kinse paisjet e tilla do te shfrytezohen ne vende te populluara me insekte dhe BREJTES . Gjeneratoret ULV jan paisje qe perdoren vetem per dezinfektime hapsinore dhe asesi kunder BREJTESVE ku qdo prodhues qe prodhojn keto paisje jan te certifikuar sipas standarteve per kete veprimtari duke dhene mundesin e shperndarjes se preparateve permes valvulave me diamter ne mikrona te cilet jan te llojeve dhe diametrave te ndryshem dhe ato mund te vendosen pastaj edhe llojeve te diametrave varesisht nga lloji i trajtimit ,gjithashtu mbasi paisjet e tilla jan paisje mobile dhe vendosen ne kamionete ato kan edhe gypin qe mund te zgjatet aq sa ka nevoj te kryhet dezinfektimi dhe aq me teper gypat e paisjeve shfrytezohen ne trajtimin e dezinfektimi e MOQALEVE e jo siperfaqeve te hapsirav te burgjeve.

*Përgjigja: Specifikacioni teknik është konforme nevojave dhe shërbimeve dhe qe janë zvogëluar sasitë e tyre ne krahasim me kërkesën para tri viteve për te mundësuar pjesëmarrje me te gjere. Sa i takon gypit, Gjatësia prej 100 metra është më e përshtatshme, bazuar në përvojën e deritashme, por për të shprehur gatishmëri për mbështetje të OE dhe ankesave të tyre, kjo gjatësi ndryshohet dhe nuk duhet të jetë më e shkurtër se 50 metra, me çka edhe ashtu do të vështirësohet procesi i punës në*



*"zona sterile" zonat ku nuk mund të kaloj askush por vetëm nga distanca behet Dezinsektimi e të cilat janë zona të sigurisë, të rrethuara me tela me gjemba afër rrethojave.*

**Pretendimi Ankimor nr. 7 - AK te Specifikimi teknik, Aneksi 1 ka kërkuar; Operatori Ekonomik, para se të nënshkruaj kontratën duhet të ketë dëshminë e policës përkatëse të sigurimit të lëshuar nga një kompani e sigurimeve shëndetësore, e licencuar,**

*Përgjigja: Operatori Ekonomik, duhet të dëshmojë se: merr përgjegjësinë e plotë për trajtimin eventual të personave të atakuar nga përdorimi i preparateve apo procesit të DDD-së në burgje për të të gjitha rasteve për trajtim profesional dhe adekuat, maksimal që kryhet brenda territorit të Kosovës duke përfshirë shoqërimin, transportin dhe procese të tjera të mundshme në këtë rast.*

*Operatori Ekonomik, para se të nënshkruaj kontratën duhet të ketë dëshminë e policës përkatëse të sigurimit të lëshuar nga një kompani e sigurimeve shëndetësore, e licencuar, për sigurimin dhe trajtimin e punëtorëve dhe palëve të treta (te burgosurve dhe stafit te burgut) nga aksidentet ne punë (intoksikacioni eventual me preparate dezinfektuese) dhe gjatë aktiviteteve që lidhen me këtë kontratë si brenda ashtu edhe jashtë vendit, 100%, përfshirë edhe dëmshpërblimin për invaliditetin dhe atë familjar. Ky është kusht i kontratës, neni 15 i Kushteve te përgjithshme te kontratës, gjegjësisht neni 15 i Kushteve te veçanta te kontratës.*

Ne baze te sqarimeve te lartcekura te dhena me arsyetime nga DSHB ne MSh, ju njoftojme se pretendimet e juaja ankimore jane pjeserisht te bazuara, dhe AK do ta beje korrigjimin e kriterëve permes Formularit standard për korrigjim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit